

VENDIM
Nr. 28, datë 9.3.2016

**MBI KËRKESËN E SHOQATËS SHQIPTARE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME
PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 13, DATË 16.2.2016, TË BORDIT TË ERE-s,
MBI TARIFËN FIKSE TË ENERGJISË, QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe nenit 16, pika 3, të "Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi ankimin administrativ të shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme AREA, për vendimin nr. 13, datë 16.2.2016, të Bordit të ERE-s,

konstatoi:

- Shoqata AREA nuk përfaqëson palë interesi, të legjitimuar për të kërkuar rishikimin e një vendimi të Bordit të ERE-s.

- Regjistrimi i hetimit gjyqësor për kundërshtimin e një tjetër vendimi të ERE-s nr. 156, datë 24.12.2015, nuk përbën provë të re, që të çojë Bordin e ERE-s në një vendimarrje të re.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme AREA, për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 16.2.2016, të Bordit të ERE-s, "Mbi tarifën fikse të energjisë , që do t'u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016".

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti